

Andi Rëmbeci (1980-) Studimet e larta i ka kryer në Departamentin e Gjuhës dhe Kulturës Greke, në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës (2004). Studimet e thelluara Pasuniversitare i përfundoi në Departamentin e Historisë të Universitetit të Jonit, Korfuz-Greqi (2005-2009) mbi Burimet Historike Bizantine dhe Paleografi dhe, ndërkohë, po kryen studimet në nivelin e doktoratës po në Universitetin e Jonit, në fushën e Historisë Bizantine. Në periudhën 2011-2012, ka kryer pranë *Centre for Byzantine Research, Institute of Historical Research – National Hellenic Research Foundation Athens* kërkime të thelluara studimore me bursën prestigjioze “*Alexander S. Onassis*”. Po ashtu, gjatë së njëjtës periudhë, ka kryer kualifikime të avancuara për Paleografi Greke-Bizantine pranë *Historical and Palaeographical Archive of the Cultural Foundation of the National Bank of Greece (MIET)* nën drejtimin e Prof. Agamemnon Tselikas dhe studime të thelluara pasuniversitare në “*Annual Postgraduate and Interdisciplinary Seminar “Nikos Oikonomides”* me fokusim në “*The period of the Macedonian dynasty (867-1056): an era of State and Church reorganization of political and intellectual flourishing and impact*”, organizuar nga Department of History and Archaeology of the University of Athens dhe Centre for Byzantine Research, Institute of Historical Research-National Hellenic Research Foundation Athens.

Ka marrë pjesë në ekspedita kërkimore shkencore brenda dhe jashtë vendit (Shqipëri, Greqi, Itali, Egjipt, Jerusalem, Austri), të organizuara nga Universiteti i Jonit (Korfuz), Universiteti i Janinës (Janinë), Arkivi Historik dhe Paleografik i Fondacionit Kulturor të Bankës Kombëtare të Greqisë (Athinë), Instituti i Studimeve Bizantine dhe Pasbizantine në Venecia. Ka qenë bashkautor dhe organizator i së parës veprimtari kulturore-shkencore publike në lëmin e kodikologjisë dhe paleografisë, zhvilluar në Arkivin Qendror Shtetëror, me temë: “Dorëshkrime Bizantine dhe Pasbizantine në Shqipëri” (maj 2010). Ka marrë pjesë e projekteve të ndryshme shkencore brenda dhe jashtë vendit, ndër të cilat së fundmi përmendim: “*Corpus i pikturës murale bizantine në Shqipëri*” (2012-), projekt i iniciuar nga Academy of Athens – Research Centre for Byzantine and Post-Byzantine Art, dhe i integruar në Corpus of Byzantine Monumental Paintings nën kujdesin e Union Académique Internationale. “*Corpus i dokumenteve arkivorë të Ali pashë Tepelenës në AQSh*” (2012-) me bashkëpunimin e Institute of Historical Research-National Hellenic Research Foundation, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Fakulteti i Filologjisë dhe i Historisë i Universitetit të Tiranës dhe Universiteti Evropian i Tiranës. “*Katalog shkencor i kodikëve bizantinë dhe pasbizantinë të AQSh-së*” (2011-), projekt me bashkëpunimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shqipërisë dhe Historical and Palaeographical Archive of the Cultural Foundation of the National Bank of Greece (MIET).

Që nga muaji nëntor 2010, është Lektor i Historisë Bizantine dhe Paleografisë në Departamentin e Historisë të Universitetit të Tiranës. Interesi i tij shkencor fokusohet në fushën e paleografisë, e historisë bizantine, e burimeve historike bizantine dhe pasbizantine. Ka marrë pjesë në Kongrese, Simpoziume dhe Konferenca Shkencore Kombëtare dhe Ndërkombëtare, brenda dhe jashtë vendit. Është autor i monografisë “*Kodiku i Korçës dhe Selasforit: botimi dhe dokumentimi historik*” (500 faqe; nën proces botimi nga Universiteti i Jonit) dhe bashkautor i botimit faksimile “*The Illuminated Gospel of Korça. Korça Codex 93 (10th century)*” (3 vëll., 1.272 fq.), si edhe i një sërë artikujsh shkencore të botuar brenda dhe jashtë vendit.

Në vitin 2016, nderohet nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë me çmimin shkencor kombëtar për “Kërkuesi i ri më i suksesshëm” për vitin 2016 për botimin “*Katërngjillëshi i dekoruar i Korçës (Kodiku i Korçës nr. 93)*”.

Është bashkëthemelues dhe, që nga viti 2013, anëtar i Bordit Drejtues dhe Sekretar i Shoqatës Shqiptare të Studimeve Bizantine, anëtare zyrtare e Association Internationale des Études Byzantines (AIEB) (www.aiebnet.gr). Prej vitit 2017 është bashkëthemelues i Akademisë së të Rinjve pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe bashkëkryetar i saj.